
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA SH.A

Data: 14. 09 .2026

Procesverbal – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

“Shërbim GPS dhe monitorim për autoambulancat”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Sisteme GPS ose të ngjashme CPV 381121004-4

VLERA E FONDIT LIMIT: 18,696,000 (tetëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, Ose 203,661 (dyqind e tre mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një) euro.

Vlerat në euro në këto dokumente tenderi janë konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, datë 14.09.2026, me kurs këmbimi 91.80.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara në rolin e Organit Qëndror Blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas Shtojcës 9;**

b. Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 4;**

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Vërtetim për xhiros vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.
2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77 "Kërkesat për kualifikim", pika 3 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës", nenin 43 "Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare" pika 2/a dhe nenin 47 "Procedura e hapur" të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar ku përcaktohet se: "Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata". Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 "Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare" pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, ku përcaktohet se:

Pika 2. "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar". Në rastin konkret nga ana e Njësisë së Prokurimit është konsideruar e arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në

procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Duke patur parasysh, përcaktimin e bërë në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a, AK nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përlllogaritur të vlerës së lotit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontrates për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 39 % e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
 - b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenin 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë ose skeda teknike të lëshuara apo të publikuara nga prodhuesi për pajisjet GPS, kamerat, kompjuterin dhe monitorët që propozon për realizimin e shërbimit. Për modulet audio dhe aksesoret duhet të paraqitet dokumentacion teknik që provon funksionet dhe përputhshmërinë e tyre me pajisjet e propozuara.

Në dokumentacion duhet të identifikohen prodhuesi dhe modeli i pajisjes së ofruar dhe të shënohen qartë karakteristikat që provojnë përputhshmërinë me specifikimet teknike. Për platformën duhet të paraqitet manual ose dokumentacion teknik i zhvilluesit/ofruesit, me referenca të dallueshme për funksionet e kërkuara në termat e referencës.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Ky kriter kërkohet për të provuar se pajisjet dhe platforma e propozuar përbëjnë një zgjidhje teknikisht të përputhshme me funksionet e shërbimit të monitorimit. Funksionimi i sistemit varet nga ndërveprimi ndërmjet pajisjes GPS, kamerës, moduleve audio, infrastrukturës së komunikimit dhe aplikacionit të monitorimit. Mospërputhja e ndërfaqeve, furnizimit elektrik ose funksioneve të mbështetura mund të pengojë transmetimin e pozicionit, marrjen e alarmeve, fotografimin ose komunikimin audio. Identifikimi i prodhuesit dhe modelit, së bashku me karakteristikat e shënuara në dokumentacionin teknik, lidh konfigurimin e ofertuar me parametrat konkretë të pajisjeve. Dokumentacioni i platformës plotëson këtë informacion duke treguar funksionet e monitorimit, raportimit dhe administrimit. Në këtë mënyrë, kërkesa mbështet përzgjedhjen e një sistemi që realizon nevojat operative të AK-së dhe ul rrezikun e papajtueshmërive gjatë instalimit dhe përdorimit.

3. Operatori ekonomik duhet të identifikojë burimin e hartës së propozuar dhe, kur ky burim kërkon licencë, të paraqesë dokumentacion që provon të drejtën e përdorimit të saj për realizimin e shërbimit. Pranohet hartë OSM, hartë e licencuar ose zgjidhje ekuivalente, sipas specifikimeve teknike.

Për burimet që nuk kërkojnë licencë individuale, operatori ekonomik duhet të identifikojë burimin dhe kushtet përkatëse të përdorimit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e

nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe në nenin 40 pika 6/b të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. ku përcaktohet se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknikë;”.

Ky kriter kërkohet sepse harta është pjesë funksionale e platformës dhe mundëson paraqitjen e pozicionit të autoambulancave, interpretimin e lëvizjes së tyre dhe identifikimin e rrugëve e zonave të interesit. Përcaktimi i burimit dhe i kushteve të përdorimit sqaron mbi çfarë shërbimi hartografik mbështetet zgjidhja e propozuar dhe nëse përdorimi i tij për objektin e kontratës është i mundësuar. Kur nevojitet licencë, dokumentacioni përkatës ul rrezikun që aksesit në hartë të kufizohet ose të ndërpritet për shkak të mungesës së të drejtave të përdorimit. Për burimet e hapura, identifikimi i kushteve të përdorimit ruan të njëjtin qëllim pa imponuar licencë individuale. Pranimi i hartës OSM, hartave të licencuara dhe zgjidhjeve ekuivalente lejon alternativa teknike që përmbushin funksionet e kërkuara nga AK.

4. Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 3 (tre) punonjës të cilet te figurojne ne listepagesat e muajit te fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates, te angazhuar për realizimin e shërbimit, me ndarjen e detyrave si më poshtë:

a. Të paktën 1 (një) specialist për konfigurimin dhe mbështetjen teknike të platformës GPS, me kualifikim ose përvojë të dokumentuar në konfigurimin, administrimin apo mirëmbajtjen e sistemeve GPS/telematike ose platformave të monitorimit të automjeteve. Për kete punonjes duhet te paraqitet Për CV dhe dokumente që provojnë kualifikimin ose përvojën përkatëse, si diplomë, dëshmi trajnimi, certifikim ose vërtetim për detyrat e realizuara.

b. Të paktën 2 (dy) teknikë për instalimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve GPS dhe moduleve shoqëruese në autoambulanca, me kualifikim ose përvojë në instalime autoelektrike/telematike. Për teknikët duhet të paraqitet diplomë, dëshmi trajnimi, certifikim ose dokumentacion tjetër ekuivalent që provon kualifikimin apo përvojën në instalime autoelektrike/telematike

Shenim: Specialisti i platformës dhe dy teknikët e instalimit duhet të jenë persona të ndryshëm. Operatori ekonomik duhet të organizojë personelin e angazhuar në mënyrë që të përmbushë afatin e instalimit dhe kërkesat e suportit, numri minimal nuk e kufizon angazhimin e personelit shtesë sipas nevojës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet

kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe në nenin 41 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri për të paktën 3 punonjës mbështetet në ndarjen funksionale të punës ndërmjet konfigurimit të platformës dhe ndërhyrjeve fizike në autoambulanca. Specialisti i platformës nevojitet për regjistrimin dhe konfigurimin e pajisjeve, parametrizimin e funksioneve, administrimin e përdoruesve dhe diagnostikimin e problemeve të komunikimit me sistemin. Dy teknikët krijojnë mundësi për ndërhyrje paralele në automjete ose për bashkëpunim gjatë montimit dhe testimit të pajisjeve e moduleve shoqëruese. Angazhimi i personave të ndryshëm mundëson që puna në terren të vazhdojë njëkohësisht me konfigurimin dhe mbështetjen e platformës. Dokumentet e kualifikimit, përvojës dhe disponueshmërisë lidhin detyrat me personelin konkret të propozuar. Ky minimum përfaqëson një strukturë bazë organizimi; mjaftueshmëria e personelit duhet të mbështetet me grafikun dhe ngarkesën reale të instalimeve e ndërhyrjeve, pasi numri prej 3 punonjësish nuk provon vetvetiu përmbushjen e afatit të instalimit ose mbulimin e suportit 24/7.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e instalimit sipas numrit, shpërndarjes dhe disponueshmërisë së autoambulancave, brenda afatit të përcaktuar në dokumentet e procedurës.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë se merr përsipër instalimin dhe vënien në funksion të pajisjeve e moduleve në autoambulanca dhe instalimin e sallës operative me dy monitorët dhe kompjuterin e kërkuar. Gjithashtu, duhet të mundësojë monitorimin nga qendrat spitalore të autoambulancave përkatëse, sipas kërkesave të AK-së.

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë se, gjatë periudhës së kontratës, merr përsipër mirëmbajtjen dhe kontrollin periodik të pajisjeve dhe software-it, si dhe mbështetjen teknike sipas kërkesave të AK-së.

8. Në deklaratë duhet të konfirmojë suport 24/7 për incidentet kritike, me fillim reagimi brenda 1 ore dhe zgjidhje ose masë të përkohshme brenda 8 orësh. Pajisja me defekt duhet të zëvendësohet brenda 24 orësh në Tiranë dhe brenda 48 orësh në qarqe, ose brenda afateve më të mira të ofruara nga operatori ekonomik.

9. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë se merr përsipër trajnimin e personelit të autoriteteve kontraktore përfituese përpara dorëzimit të pajisjeve, për përdorimin e zgjidhjes së instaluar. Gjatë periudhës që mbulon kontrata, operatori ekonomik duhet të jetë i gatshëm të organizojë, me shpenzimet e tij dhe sipas kërkesave të autoriteteve kontraktore përfituese, trajnimin e punonjësve të caktuar prej tyre.

Argumentimi: Ky kriter vendoset në përputhje me piken 8, të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: *AK-ja përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

4. Infrastruktura e serverit dhe vazhdimësia e komunikimit

Ky kriter kërkohet për të siguruar dimensionimin e infrastrukturës sipas ngarkesës së të paktën 380 pajisjeve, si dhe përdorimit të platformës nga përdoruesit e autorizuar. Përpunimi i të dhënave të pozicionit, alarmeve, raporteve dhe fotografive kërkon burime përpunuese, memorie, ruajtje dhe komunikim të përshtatura me ritmin e transmetimit dhe historikun që duhet të mbahet. Nëndimensionimi mund të sjellë vonesa në shfaqjen e informacionit, kufizim të raporteve ose ndërprerje të shërbimit. Lidhja rezervë përmes rrugëve, teknologjive ose ofruesve të pavarur ul varësinë nga një lidhje e vetme, pa përbërë vetvetiu garanci kundër çdo ndërprerjeje. Deklarimi i hostimit dhe nënkontraktorëve qartëson infrastrukturën dhe palët që përfshihen në trajtimin e të dhënave. Angazhimi për mbulimin e hapësirës gjatë kontratës dhe respektimin e kërkesave për të dhënat mbështet vazhdimësinë dhe përgjegjësinë për ofrimin e shërbimit.

5. Grafiku i instalimit dhe vënia në funksion

Ky kriter kërkohet për të lidhur realizimin teknik të shërbimit me numrin, shpërndarjen territoriale dhe disponueshmërinë e autoambulancave. Instalimi kërkon koordinim me institucionet përfituese, pasi automjetet përdoren në shërbimin e urgjencës dhe nuk mund të konsiderohen njëkohësisht të lira për ndërhyrje. Grafiku mundëson organizimin e instalimeve dhe angazhimit të personelit sipas afatit kontraktual, duke kufizuar kohën e qëndrimit të automjeteve jashtë përdorimit. Përfshirja e sallës operative, dy monitorëve, kompjuterit dhe aksesit të qendrave spitalore lidh pajisjet e instaluar me pikat ku informacioni do të përdoret. Deklarata dokumenton marrjen përsipër të vënies në funksion të zgjidhjes së plotë, në mënyrë që AK të marrë një shërbim të përdorshëm monitorimi dhe komunikimi, me komponentët e kërkuar që funksionojnë së bashku.

6. Mirëmbajtja dhe mbështetja teknike

Ky kriter kërkohet për të ruajtur funksionimin e shërbimit gjatë gjithë kontratës, duke marrë parasysh se defektet në pajisje, komunikim ose software mund të cenojnë informacionin që salla operative merr për autoambulancat. Mirëmbajtja dhe kontrollet periodike ndihmojnë në identifikimin e problemeve përpara se ato të shkaktojnë ndërprerje të zgjatura. Suporti 24/7 për incidentet kritike lidhet me përdorimin e shërbimit të urgjencës pa kufizim orari. Fillimi i reagimit brenda 1 ore synon nisjen e shpejtë të diagnostikimit, ndërsa zgjidhja ose masa e përkohshme brenda 8 orësh synon kufizimin e ndikimit operacional. Afatet e zëvendësimit prej 24 orësh në Tiranë dhe 48 orësh në qarqe përcaktojnë kohën e lejuar për ndërhyrjen fizike sipas vendndodhjes. Deklarata i bën këto angazhime të shprehura, ndërsa përmbushja e tyre duhet të ndiqet gjatë zbatimit të kontratës.

7. Trajnimi i personelit të autoriteteve përfituese

Ky kriter kërkohet sepse përdorimi efektiv i sistemit varet edhe nga aftësia e personelit për të interpretuar informacionin dhe për të përdorur saktë funksionet e platformës. Trajnimi përpara dorëzimit mundëson që përdoruesit të njihen me monitorimin e pozicionit, alarmet, komunikimin audio dhe raportet përpara përdorimit operacional. Kjo ul rrezikun e gabimeve të përdorimit, keqinterpretimit të informacionit ose vonesave në shfrytëzimin e funksioneve të sistemit. Mundësia e trajnimit gjatë kontratës mbulon nevojat që lindin nga ndryshimi i personelit, përditësimet e zgjidhjes ose vështirësitë e evidentuara gjatë punës. Angazhimi për organizimin e trajnimit me shpenzimet e operatorit e përfshin mbështetjen e përdoruesve në shërbimin e kontraktuar dhe i mundëson AK-së të shfrytëzojë funksionalitetet e instaluar gjatë gjithë periudhës së përdorimit.

Argumentimi: Specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga autoriteti kontraktor përfitues **Qendra Kombetare e Urgjences Mjekesore Tirane**, në përputhje me nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Neni 36 pika 3 përcakton: 3. *Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;*

Duke ju referuar nenit 36 autoriteti kontraktor përfitues **Qendra Kombëtare e Urgjences Mjekësore Tirane**, ka hartuar specifikimet teknike të cilat shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të shërbimeve objekt prokurimi, autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

NJËSIA E PROKURIMIT